

Në përputhje me Nenin 28 paragrafi 3 i Ligjit 9723/2007 Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit Ky dokument përbën:

**AKTI I THEMELIMI**

**DHE**

**STATUTI**

**I**

**SHOQËRISË**

**“BATTLENET” SH.P.K**

**TIRANË / SHQIPËRI**

**AKTI I THEMELIMIT**  
**DHE**  
**STATUTI I SHOQËRISË**  
**(“Statuti”)**

**I**

**Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**  
**“BATTLENET ” SH.P.K**  
**(“Shoqëria”)**

**Neni 1**

**Emri i Shoqërisë dhe forma ligjore**

- 1.1 Në bazë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, themelohet Shoqëria **“BATTLENET” SH.P.K** i ndjekur në mënyrë të pandashme nga shtojca **“SH.P.K”** që përfaqëson formën juridike të saj, së cilës këtej e tutje do i referohemi shkurtimisht si **“Shoqëria”**
- 1.2 Shoqëria ka statusin e Personit Juridik, në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 **“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (“Ligji për Shoqëritë”)** dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 1.3 Shoqëria fiton personalitet juridik nga moment i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit(**“QKR”**), në përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 **“Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit**
- 1.4 Ortaku i Shoqërisë (**“Ortaku”** ose **“Ortaku i Vetëm”**) dhe për shmangien e çdo dyshimi Ortaku themelues, gëzon përgjegjësi të kufizuar deri në kufirin e kontributeve përkatëse të tij në kapitalin e përfaqësuar në kuota.
- 1.5 Në çdo dokument, fatura, njoftimet apo publikime të bëra nga Shoqëria, pavarësisht nga mjetet e transmetimit, emri i Shoqërisë duhet të paraprihet ose të ndiqet nga:
  - a. Fjalët **“Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar”** ose **“SH.P.K”**
  - b. Numri unik i identifikimit (NIPT)
  - c. Selinë e regjistruar dhe zyrën qendrore
  - d. Të dhëna nëse Shoqëria është në proces likuidimi



## Neni 2

### Selia

Selia ligjore e Shoqërisë do të jetë: **Rruga e Barrikadave, Pall. Invest Soc, Kt 1, Dyq 1, Tirane.** Shoqëria me Vendim të Ortakëve mund të zhvendosë selinë e saj ose të krijojë një qendër operative në një vend tjetër në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë ose linjë prodhimi përfaqësimi në çdo vend Brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë sipas gjykimit të Ortakëve.

## Neni 3

### Objekti i Aktivitetit të Shoqërisë

3.1 Objekti i Aktivitetit të Shoqërisë është:

- E- gaming
- Lojëra elektronike kreative
- Lojëra playstation dhe Xbox të teknologjisë së lartë
- Turne lojërash esports
- Evente dhe kompeticione esports
- Bar-Kafe dhe Snac bar
- Import – export produkte gaming
- Import- export paisje kompjuterike
- Konsulta ne fushen e TIK
- Shërbime printimi e scanimi, fax etj
- Servis e mirëmbatje paisje kompjuterike
- Krijim dhe mirëmbatje website
- Marketing on-line
- Mirëmbatje rrjete sociale

Gjithashtu në përputhje me legjislacionin shqiptar, mund të kryejë dhe realizojë çdo aktivitet, që lidhet direkt ose indirekt, që është pasojë e. apo e lidhur me aktivitetet e listuara më lart. Për të arritur qëllimin e mospërm, Shoqëria mund të ndërmarrë çdo aktivitet dhe shërbim qoftë tregtar, financiar, për dhënie e marrje me qira e hipotekim, që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm në mënyrë që të arrihet objekti i Shoqërisë.

3.2 Shoqëria mund të ndërmarrë çdo veprimtari që është në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj, i lidhur me të dhe në interes të saj.

3.3 Shoqëria mund të krijojë ose të marrë pjesë në shoqëri, sipërmarrje të përbashkëta, partneritete dhe të gjitha format e bashkëpunimit, brenda qëllimit dhe objektivave të saj.

3.4 Shoqëria duhet të zbatojë të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse. Ajo duhet t'i përmbahet standardeve më të mira etike.

3.5 Shoqëria ka të drejtën të bëjë ndryshime të qëllimit të aktivitetit të saj në çdo kohë sipas këtij Statuti.



**Neni 4**  
**Kohëzgjatja e Shoqërisë**

Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë të pakufizuar duke filluar nga koha e regjistrimit në QKR. Për shkaqe dhe arsye të ndryshme, Shoqëria mund të mbarojë aktivitetin e saj në çdo kohë. Kjo do të bëhet në përputhje me normat e Statutit dhe Legjislacionit në fuqi.

**Neni 5**  
**Kapitali i Regjistruar dhe Kontributet në Kapital**

5.1 Kapitali i Regjistruar i Shoqërisë është 10.000 LEKE (dhjete mijë leke). Kuota është e pjestueshme, e transferueshme, e trashëgueshme në përputhje me legjislacionin shqiptar.

5.2 Kapitali Themeltar i Shoqërisë prej 10.000 LEKE (dhjete mijë) zotërohet si mëposhtë:

1. **Z. Ogert Rexha** i biri i Cane-s, lindur në Tiranë më datë **29/07/1979**, identifikuar me Numer Personal H90729041L . Kontributi i tij në Kapitalin e Regjistruar të Shoqërisë do të jetë në shumën 10.000 (dhjete mije mijë) LEKË, e cila e bën **Z. Ogert Rexha** zotërues të 100% (njëqind për qind) të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë

5.3 Depozitimi i Kapitalit Themeltar të Ortakut në Kapitalin Themeltar të Shoqërisë do të kryhet me një kontribut të vetëm në para dhe do të paguhet dhe depozitohet përmes një llogarie bankare të hapur në një institucion bankar operues në Republikën e Shqipërisë.

5.4 Shoqëria mund të vendosë me deskricionin e saj për mbajtjen e librit të ortakëve, nën kujdesin e Administratorit , me qëllim për të reflektuar çdo të drejtë të Ortakëve apo të drejtë të palëve të treta mbi kuotat e Shoqërisë (Libri i Ortakëve). Libri i Ortakëve do të përmbajë këto informacione:

- Numrin e kuotave të zotëruara nga Ortaku/ët;
- Datën kur Ortaku apo Ortakët ka fituar pronësinë mbi kuotat
- Emrin dhe adresën apo selinë e Ortakut(Ortakëve)
- Vlerën e kuotave përkatëse të zotëruara; dhe
- Të dhëna mbi çdo pengm barrësim ose çdo të drejtë tjetër reale mbi kuotat.
- Ortaku (Ortakët) kanë të drejtën, që me anë të kërkesës me shkrim, të kërkojnë një ekstrakt to Librit të Ortakut me vulën e Shoqërisë. Ortaku; (Ortakët) ka të drejtën të verifikojë regjistrimin në Librin e Ortakut (Ortakëve) dhe Administratori (Administratorët), nëse kjo kërkohet me shkrim, duhet të sigurojnë asistencën e nevojshme për Ortakun (Ortakët).

5.5 Kuotat do të transferohen në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe dotëregjistrohen në Qendrën Kombëtare të Rëgjistrimit si dhe në Librin e Ortakut (Ortakëve).



## **Neni 6**

### **Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit**

6.1 Në vijim, Ortaku mund të vendosë të zmadhojë ose të zvogëlojë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë në çdo kohë në përputhje me nenet e këtij Statuti dhe në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

6.2 Shoqëria ka të drejtë të blejë dhe të anullojë kuotat e saj, si rezultat i zvogëlimit të kapitalit të regjistruar.

6.3 Kapitali I Regjistruar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve në para ose kontributeve në natyrë, si edhe përmes përfshirjes në to të rezervave ose fitimeve apo edhe përmes konvertimit të borxheve në kuota kapitali.

6.4 Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet përmes sigurimit të kuotave të reja ose rritjes të vlerës nominale të kuotave ekzistuese. Kuotat duhet të regjistrohen dhe vlera e tyre nominale duhet të paguhet plotësisht.

## **Neni 7**

### **Drejtimi dhe Organizimi i Shoqërisë**

Drejtimi i Shoqërisë është e ndarë ndërmjet :

- a. Ortakut (Ortakët)
- b. Administratori/ët.

## **Neni 8**


### **Ortaku /ët**

8.1 Ortaku/ët është organi më i lartë i vendimmarrjes në Shoqëri.

8.2 Pronësia mbi kuotat i jep zotëruesit të tyre të drejtat dhe detyrimet, siç parashikohen në Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga pronësia mbi kuotat janë të transferueshme në çdo zotërues të ri të këtyre Kuotave.

8.3 Ortaku/ët ka të drejtën për të vendosur mbi:

- a. Përcaktimin e politikave tregtare dhe të investimit të Shoqërisë.
- b. Ndryshimin e Statutit.
- c. Emërimin dhe shkarkimin e Administratorit (Administratorëve) dhe miratimin e skemave të shpërblimeve të tyre
- d. Emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël të autorizuar të pavarur dhe likujduesve dhe miratimin e skemës së shpërblimeve të tyre.
- e. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare, përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore, llogarive dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë, nga Administratort.
- f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë, mbi bazën e dokumentave përkatës.



- g. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, mbi bazën e dokumentave përkatëse.
- h. Shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve.
- i. Pjestimi i kuotave dhe anulimim i tyre.
- j. Përfaqësimi i Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera kundër Administratorit (Administratorëve).
- k. Hapjen e degëve dhe filialeve.
- l. Moszbatimin e nenit 17 të Ligjit të Shoqërisë Tregtare mbi ndalimin e konkurrencës. Çdo çështje tjetër sic parashikohet në nenin 82 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- m. Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë; dhe
- n. Çështje të tjera të parashikuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.

8.4 Ortaku/ët mund të thirret për të vendosur për çështjet e mëposhtme, si një kërkesë e detyrueshme e nenit 82 to Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

- a. Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton rreziku që aktivët e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- b. Kur ka një propozim për të shitur apo për të disponuar në mënyrë tjetër aktive asete të cilat kanë një vlerë prej më të lartë se 5% të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

8.5 Në përputhje me nenin 92 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare Ortaku/ët mund t'i kërkojë gjykatës përkatëse anulimin e vendimeve të Administratorit (Administratorëve), kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të Statutit apo të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

8.6 Detyrimet e Shoqërisë, janë të garantuara përmes kapitalit e saj, dhe Ortaku (Ortakët) kanë përgjegjësi deri në vlerën e koutave të mbajtura prej tij/tyre, Ortakët nuk kanë përgjegjësi tej vlerës së investimeve të tyre në kapitalin e Shoqërisë (me përjashtim të huave dhe garancive).

8.7 Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borxhet apo detyrimet të tjera personale të Ortakut (Ortakëve) të saj.

## Neni 9

### Procesi i Vendimarrjes së Ortakut/ëve

9.1 Ortaku/ët mund të marrë vendim përmes thirrjes në mbledhje apo në formë të shkruar , në cdo rast kur konsiderohet në të mirë të Shoqërisë.

9.2 Në rast se Ortaku/ët do të marrë vendim në formën e shkruar, Administratori (Administratorët) do t'i dërgojë Ortakut tekstin e vendimit të propozuar sëbashku me dokumentacionin që mbështet vendimin me poste, faks apo me mjete elektronike të sigurta të paktën shtatë ditë para datës së propozuar për mbledhjen e asamblesë. Ortaku duhet të miratojë dhe të kthejë vendimin brenda 15 ditëve nga data e dërgimit tek Ortaku/ët të vendimit me shkrim. Ortaku miraton vendimin duke kthyer një kopje të firmosur të vendimit të shkruar tek Administratori (Administratorët) në selinë e Shoqërisë.



9.3 Vendimet e Ortakut të hartuara në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe këtë Statuti do të kenë fuqi detyruese për Shoqërinë. Vendime të tilla mund të merren jashtë Republikës së Shqipërisë dhe evidenca me shkrim e këtij vendimi duhet t'i dorëzohet Administratorit (Administratorëve), i cili (të cilët) duhet të regjistrojë në Regjistrin e Vendimeve të Ortakut (Ortakëve).

9.4 Ortaku thirret për vendimmarrje nga Shoqëria të paktën një herë në vit. Megjithatë kjo thirrje është e detyrueshme në përputhje me rastet e paraqitura në pikën 9.4 të këtij statuti.

9.5 Administratori (Administratorët) duhet të sigurojë që njoftimi i Ortakut duhet bërë në përputhje me formën dhe përmbajtjen në nenin 83 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Mospërmbushja e formaliteteve të njoftimit i bën vendimet e Ortakut të pavlefshme, vetëm nëse Ortaku njihet dhe pranon parregullsitë, deri në masën e lejuar nga ligji.

9.6 Në rastet ku kërkohet nga ligji, disa vendime të Ortakut duhet të noterizohen nga një noter publik shqiptar. Nëse këto vendime janë marrë jashtë Republikës së Shqipërisë, ato duhet të hartohen në përputhje me ligjin shqiptar për njohjen e dokumentave të huaja në Republikën e Shqipërisë (p.sh procedurat e apostilimit apo superlegalizimit, sipas vendit të marrjes së vendimit).

9.7 Të gjitha vendimet e Ortakut të vetëm duhet të regjistrohen në procesverbal dhe në regjistrin e vendimeve të Ortakut. Mbajtur nën kujdesin e Administratorit (Administratorëve) dhe në përputhje me nenin 90 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare ("Regjistri i Vendimeve të Ortakut"). Të dhënat e hedhura në këtë regjistër nuk mund të tjetërsohen apo të ndryshohen.

## **Neni 10** **Administratori/ët**

10.1 Shoqëria administrohet nga një administrator

10.2 Ortaku/ët mund të ndryshojë në çdo kohë nëse e konsideron të nevojshme numrin e administratorëve.

10.3 Administratori mund të jetë i çdo shtetësie dhe emërohet për një periudhë prej pesë vjetësh me të drejtë riemërimi.

10.4 Sipas nenit 95 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe nenit 13 të po këtij ligji, i cili citon kushtet e kualifikimit, administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të emërohet, si administrator të një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas.

10.5 Në rastet e vdekjes, dorëheqjes, largimit, apo diskualifikimit të çdo Administratori/t, zëvendësuesi i tij duhet të emërohet me vendim të Ortakut/(Ortakëve).

10.6 Ortaku (Ortakët) ka të drejtë të largojë Administratorin (Administratorët) me vendim me shkrim.



10.7 Administratori pranon që marrëdhënia e tyre në Shoqëri bazohet në mirebesim, në këtë mënyrë vendimi i Ortakut (Ortakëve) për të larguar administratorët konsiderohet një arsye legjitime, në bazë të legjislacionit të zbatueshëm.

10.8 Në rastet kur për lidhjen, ndryshimin dhe zgjidhjen e transaksionit (transaksioneve) kontratës (kontratave) kërkohet një marrëveshje e përbahkët e administratorit (Administratorëve) dhe një marrëveshje e tillë nuk arrihet çështja do t'i referohet Ortakut (Ortakëve) i cili do të zgjidhë çështjen me vendim.

10.9 Ortaku mund të miratojë vendimin i cili i jep të drejtën Administratorit (Administratorëve) që të përfaqësojnë të gjithë bashkë ose individualisht dhe/ose të drejtën për të kryer disa transaksione.

10.10 Administratori duhet të kryejë në çdo kohë ato veprime të kërkuara nga Ortakët në përputhje me këtë Statut dhe ligjin.

10.11 Administratori i parë dhe i vetëm i Shoqërisë do të jetë :

**Z. Ogert Rexha**, I biri i Cane-s , lindur në Tiranë me datë **29/07/1979**, identifikuar me Numer Personal H90729041L.

10.12 Administratori mund të hapë llogari bankare me firmë të vetme.

**Z. Ogert Rexha** është i autorizuar të kryejë të gjitha transaksionet e nevojshme për të hapur llogarinë përkatëse me qëllimin e depozitimit të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

10.13 Shoqëria duhet të rimbursojë Administratorin për shpenzimet e udhetimeve të arsyeshme të lidhura me prezencën e Administratorit në një vend jashtë vendbanimit të Administratorit në të mirë të Shoqërisë, vetëm nëse ky rimbursim është bërë pjesë e shpërblimit të të njëjtës.

## Neni 11

### Te drejtat e Administratorit(Administratoreve)

11.1 Administratori është përgjegjës për drejtimin dhe përfaqësimin e Shoqërisë.

11.2 Në vecanti Administratori ka të drejtën dhe detyrimin për të vendosur personalisht dhe të përfaqësojë shoqërinë në:

- a. Drejtimin e biznesit të Shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare të krijuar nga Ortakët.
- b. Të kujdeset për mirëmbajtjen e sakte e të rregullt të dokumentave dhe librave të kontabilitetit të Shoqërisë.
- c. Përgatitje dhe nënshkruaje bilancin vjetor dhe bilancet e konsoliduara, si dhe raportet të ecurisë së veprimtarisë dhe i paraqet për miratim të Ortaku bashkë me propozimin për shpërndarjen e fitimeve
- d. Krijimin e një sistemi paralajmërimi kohën e duhur në lidhje me rrethanat që kërcenojnë ekzistencën e Shoqërisë;
- e. Raportimin tek Ortaku në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve të një rëndësie të vecante për veprimet e Shoqërisë;



- f. Supozimin, sipas formes se nje marreveshjeje ose cdo forme tjeter, e cdo sipermarrije te Shoqerise kundrejt te treteve si dhe transferimin apo blerjen e cdo kuote te Shoqerise nga apo per palet e treta.
- g. Supozimin, sipas formes se nje marreveshjeje ose cdo forme tjeter, lidhjen e cdo kontrate apo ndermarrjen e cdo veprimi apo transaksioni.
- h. Te kryeje detyra te tjera te percaktuara nga ligji apo Ortaku/et.
- i. Te kryeje regjistrimet dhe dergoje to dhenat e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit kur eshte e nevojshme

## Neni 12

### Detyrimi i besnikerise dhe pergjegjesia e Administratorit

12.1 Sipas detyrimit te besnikerise te paraqitur ne Nenet 14, 15, 17 dhe 18 te Ligjit per Shoqerite Tregtare, Administratori (Administratores) duhet te:

- a. te kryejne detyrat e tyre te percaktuara nga ligji apo ky Statut ne mirebesim dhe ne interes te Shoqerise, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se Shoqerise ne mjedis;
- b. te ushtrojne kompetencat qe u njihen me ligj ose nga ky statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- c. te vleresojne me pergjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim.
- d. te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te Shoqerise
- e. te garantoje miratimin e marreveshjeve sipas dispozitave te pikes 3 to nenit 13 te Ligjit per Shoqerite Tregtare.
- f. te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem

12.2 Administratori (Administratores) gjate kryerjes se detyrave pergjigjen kundrejt Shoqerise per cdo veprim ose mosveprim qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e Shoqerise, me perjashtim te rasteve kur ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi apo mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

12.3 Ne rast te shkeljes se detyres dhe standarteve profesionale, sipas pikave 18.1 dhe 18.2 te ketij neni, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje Shoqerise cdo fitim personal qe ka realizuar gjate kryerjes se ketyre veprimeve te parregullta. Ai ka barren e proves per te vertetuar se kryen detyrat e tij ne rregull dhe sipas standarteve. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje Administrator ata pergjigjen ndaj Shoqerise ne menyre solidare.

12.4 Ne vecanti, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine per demet nqs ne kundershtim me ligjin kryen veprimet e meposhtme

- a. I kthen Ortakut/ve kontributet
- b. I paguan interesa apo dividente te ortakeve
- c. Shperndarjen e Aseteve te Shoqerise
- d. Lejon te vazhdoje aktivitetin e Shoqerise kur duhet parashikuar qe ajo nuk do te kete mundesi te paguaje borxhet e saj.
- e. Te jape hua/borxhe



## VEPRIMTARIA E SHOQERISE

### Neni 13 Ekspertet Kontabel


- 13.1 Ortaku/ët emëron/jn ekspertin kontabël të shoqërisë në numrin dhe kohëzgjatjen e përcaktuar nga legjislacioni shqiptar
- 13.2 Eksperti kontabel do të kryejë funksionet e auditimit në përputhje me ligjin shqiptar
- 13.3 Mandati i Eksperteve kontabel do të jetë një vjeçar
- 13.4 Viti Financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 dhjetor. Viti i parë Financiar fillon me datën e themelimit të Shoqërisë
- 13.5 Shoqëria do të mbajë llogaritë në lekë dhe në monedhë të huaj

### Neni 14 Kuotat e Shoqërisë

- 14.1 Kuotat e Shoqërisë janë lehtësisht të transferueshme përputhje me ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe në vecanti me nenin 73 të këtij Ligji
- 14.2 Ortaket mund të ndajnë kuotat e tyre me qëllimin e transferimit të pjesëve të këtyre kuotave në përputhje me ligjin Shqiptar për Shoqëritë Tregtare

### Neni 15 Shpërndarja e fitimeve

- 15.1 Ortaku/et ka të drejtën e përfitimit prej shpërndarjes së fitimit të deklaruar të Shoqërisë bazuar në bilancin e Shoqërisë të miratuar nga Ortaku/et
- 15.2 Nga fitimet vjetore krijohet një fond rezerve në përputhje me kushtet e legjislacionit Shqiptar
- 15.3 Shoqëria mund të shpërndajë fitimet tek ortaket vetëm nëse pas kësaj shpërndarje:
  - a. Asetet e Shoqërisë do të mbulojnë plotësisht detyrimet e kësaj të fundit
  - b. Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që behen të kerkueshme brenda 12 muajve të ardhshëm
- 15.4 Administratoret leshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 16.2 me sipër. Ndërsa kur gjendja e Shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratoret nuk mund të leshojnë këto certifikate.
- 15.5 Administratoret janë përgjegjës ndaj Shoqërisë në lidhje me vërtetësinë e Certifikatës së aftësisë paguese
- 15.6 Sipas nenit 78 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare ortaku/et dhe administratori/ret e shoqërisë kanë përgjegjësi personale për shpërndarjet të cilat bien në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare



**Neni 16**  
**Dispozita te ndryshme**

16.1 Ky statut mund te ndryshohet ose te zevendesohet me nje tjeter vetem me vendim teortakut/eve.

16.2 Riorganizimi, ndryshimi i formes ligjore apo prishja e Shoqerise do te behet ne perputhje me dispozitat e ligjit per Shoqerite Tregtare.

16.3 Ortaku/et dhe administratori/ret do te veprojne me parimet e ligjit per Shoqerite Tregtare dhe ne vecanti ne perputhje me dispozitat e pjeses se pare, kapitulli 4 to ligjit Per Shoqerite Tregtare.

16.4 Personat te cilet jane perfshire ne krime te kryera gjate detyres se tyre ne Shoqeri sipas nenit 163 deri 170 pika a) e Kodit Penal nuk mund te kryejne funksionet e perfaqesuesit ligjor, administratorit dhe te perfaqesuesit te shoqerise per nje periudhe prej 5 vjetesh nga kryerja e denimit.

16.5 Shoqeria duhet te perfshije ne raportin e saj vjeter nje pasqyre koherente dhe pershkruese, e cila permban pikat kyce te rregullave per drejtimin e Shoqerise dhe praktikave qe aplikon ne perputhje me ligjin per Shoqerite tregtare.

16.6 Ortaku me propozimin e Administratorit/ve, mund te vendosi per krijimin e nje fondi rezerve per te permbushur te papriturat e Shoqerise ose per barazimin e fitimeve ose per ruajtjen e cdo pasurie te Shoqerise, ose per çdo qellim tjeter qe ortaku konsideron ne interes to Shoqerise.

16.7 Te gjitha çeshtjet qe nuk jane rregulluar shprehimisht ne kete Statut, i nenshtrohen rregullimit nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite

**ORTAKU**

**OGERT REXHA**

Ogert Rexha



**Tiranë, më 14.01.2021**